



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 287 prot.

Himarë, 21. 01. 2022

N J O F T I M

Lënda : Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë.

I/E nderuar këshilltar/e.

Ju njoftoj se ditën e premte, datë 28.01. 2022, ora 10.00 paradite në sallën e stadiumit “Petro Ruci” Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin janar, e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 4, sipas kushteve të masave anti-covid me këtë rend dite:

1-Mbi miratimin e tematikës vjetore të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Himarë,për vitin 2022.

2-Për miratimin e planit të punës “Për menaxhimin e suksesshëm të sezonit turistik 2022 dhe planit të veprimit përkatës”.

3- Miratimi i Projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Himarë,së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Miftar Dautaj dhe Vllashi Petrol ,të cilat janë dëmtuar nga zjarri”.

4-Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastruktur e disa projekteve të infrastrukturës publike, ku Bashkia Himarë është bashkëinvestitor dhe përfitues .”

5-Miratimi i Projektvendimit “Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ,si dhe nga fondet e buxhetit vendor”.

6-Miratimi i Projektvendimit “Për shërbimet e kujdesit shoqëror ,nga fondet e Bashkisë”.

7-Miratimi i Projektvendimit “ Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike ,periudhën 1-31 dhjetor, 2021,nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok- ndihmës ekonomike”.

8-Miratimi i Projektvendimit “ Për miratimin e procesit të zgjedhjeve të kryesive të fshatrave, e të kryetarëve të tyre, në fshatrat Kallarat dhe Kuç, Bashkia Himarë

9- Të ndryshme.

SEKRETARI

Elena Memushaj

